

DEKRET
Nr.183, datë 18.5.1992

**PËR SHFUQIZIMIN E DEKRETIT NR.7399, DATË 8.7.1990 "PËR DISA NDRYSHIME NË
KODIN E PUNËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, e ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

DEKRETOJ:

1. Dekreti nr.7399, datë 8.7.1990, "Për disa ndryshime në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet.

2. Deri në datën 30 qershor 1992, për ndërprerjet në punë punonjësve t'u jepet një pagesë tranzitore papunësie që do të përballohet nga buxheiti i shtetit.

Këshilli i Ministrave cakton masën dhe rregullat për dhënien e pagesës tranzitore të papunësisë.

3. Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

Miraturar nga Kuvendi Popullor me ligjin nr.7571, datë 10.6.1992.